

VENDIM
Nr. 172, datë 16.8.2021

**MBI RISHIKIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-s NR. 90, DATË 6.4.2021,
“MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘ALBPETROL’ SHA, NË AKTIVITETIN E
FURNIZIMIT TË GAZIT NATYROR” (SHITJE ME PAKICË)**

Në mbështetje të nenit 22, pika 2, germa “c” dhe nenit 23, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar; nenit 113, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë; nenit 4, pika 1, germa “c”; nenit 5; nenit 9, pika 1, germa “d”/vi; si dhe nenit 9, pika 1, germa “e”/i, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 97, datë 4.7.2017; nenit 15, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 16.8.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 102/4-1 prot., datë 11.8.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, si dhe Drejtoria e Gazit Natyror, “Mbi rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 90, datë 6.4.2021, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Albpetrol’ sh.a., në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror” (shitje me pakicë)”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 90, datë 6.4.2021, vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “Albpetrol” sh.a., në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror (shitje me pakicë), për një afat 10-vjeçar, me kusht që brenda 3 (tre) muajve nga marrja dijeni e këtij vendimi të depozitojë në ERE:

a) vërtetimet e Gjykatës dhe të Prokurorisë për administratorin e ri të saj dhe vërtetimet e Gjykatës dhe Prokurorisë për vetë shoqërinë “Albpetrol” sh.a., me data të përditësuara;

b) deklarime të lëshuara prej autoriteteve përkatëse për shlyerjen e detyrimeve fiskale dhe sigurimeve shoqërore, në masën që këto detyrime janë plotësuar prej aplikantit.

2. Shoqëria “Albpetrol” sh.a., të depozitojë në ERE përpara fillimit të operimit dokumentacionin pronësor dhe lejet mjedisore në original ose të njësuar me origjinalin.

- ERE iu drejtua shoqërisë me shkresën nr. 120/6 prot., datë 9.4.2021, duke i njoftuar vendimin përkatës dhe ka bërë me dije detyrimin për të paraqitur brenda afateve të vendimit, dokumentacionin e munguar, pjesë e kushteve të tij.

- Shoqëria “Albpetrol” sh.a. me shkresat e protokolluara në ERE, nr. 120/7 prot., datë 25.6.2021 dhe nr. 120/8 prot., datë 6.7.2021, ka përcjellë dokumentacion në kuadër të plotësimit të kushteve të vendimit të licencimit, dhe nga analizimi i tij rezulton plotësimi i kushteve si më poshtë:

- kushti i vendosur në pikën 1, germa “a”, vërtetimet e Gjykatës dhe të Prokurorisë për administratorin e ri të saj dhe vërtetimet e Gjykatës dhe Prokurorisë për vetë shoqërinë “Albpetrol” sh.a., me data të përditësuara, është plotësuar nga shoqëria;

- kushti i vendosur në pikën 1, germa “b”, deklarime të lëshuara prej autoriteteve përkatëse për shlyerjen e detyrimeve fiskale dhe sigurimeve shoqërore, në masën që këto detyrime janë plotësuar prej aplikantit”, konsiderohet i plotësuar pjesërisht duke qenë se “Albpetrol” sh.a. ka detyrime (gjoba dhe kamatëvonesa) ndaj institucionit tatimor. Ndodhur në këto rrethana u vlerësua vendosja e një kushti për depozitim në vijim të vërtetimit respektiv pa detyrime tatimore, i cili nuk lidhet me fillimin e operimit të aktivitetit të licencuar, duke i dhënë mundësinë shoqërisë që të krijojë të ardhura nga veprimtaria e licencuar, për shlyerjen e debive ndaj tatimeve dhe t’i demonstrojë ato periodikisht në ERE (siç edhe vetë shoqëria ka deklaruar);

- kushti i vendosur në pikën 2, të vendimit nr. 90, datë 6.4.2021, “Shoqëria ‘Albpetrol’ sh.a., të depozitojë në ERE përpara fillimit të operimit dokumentacionin pronësor dhe lejet mjedisore në origjinal ose të njësuar me origjinalin”, është plotësuar nga shoqëria. Megjithatë, në kuptim të parashikimeve të nenit 9, pika 1, germa “d”/vi, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 4.7.2017, shoqëria “Albpetrol” sh.a., duhet të depozitojë në mënyrë periodike në ERE çdo dokument pronësor dhe mjedisor që i shërben ushtrimit të veprimtarisë së licencuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 90, datë 6.4.2021, bëhen ndryshimet si vijon:

a) Pika 1

Bëhet:

1. Të licencojë shoqërinë “Albpetrol” sh.a., në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror (shitje me pakicë), për një afat 10-vjeçar.

b) Pika 2

Bëhet:

2. Shoqëria “Albpetrol” sh.a. duhet të depozitojë çdo 3 (tre) muaj në ERE çdo dokument pronësor dhe mjedisor që i shërben ushtrimit të veprimtarisë së licencuar.

c) Pas pikës 2, shtohen pikat 3 dhe 4, me këtë përmbajtje:

3. Shoqëria “Albpetrol” sh.a. të dokumentojë në ERE brenda 6 (gjashtë) muajve kryerjen e të gjitha pagesave ndaj institucionit të tatimeve.

4. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, si dhe Drejtoria e Gazit Natyror të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti